



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR. I VENDIMIT.: KPCC/D/R/167/2012
DATA E VENDIMIT: 05/09/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler.

URDHËR

(1) Në secilën prej 86 (tetëdhjetë e gjashtë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(2) Në secilën prej 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesave të identifikuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

(3) Në kërkesat me nr. 00882, 01187, 01376, 11545, 22314, 22644, 25024, 32318, 35345, 35955, 36298, 40052, 40324, 48287, 48664 dhe 53122, të referuara në pjesët A, B, C dhe D Komisioni më tutje vendos që kërkesa të hidhet poshtë kur paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks (“Aneksi I”) i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës (“AKP”) si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Anekset e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetë nga 3 deri 5 shtator 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 334 kërkesa për pronë banesore në seancën e tridhjetë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Një kërkesë për pronë banesore, e cila i ishte paraqitur Komisionit, iu kthye Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtejme dhe një kërkesë për pronë banesore u tërhoq nga Sekretari Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e pesë kërkesave banesore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Përveç këtyre, Komisioni zgjidhi dy kërkesa të cilat më parë ishin në pritje të seancës dëgjimore. Gjithsej 329 kërkesa për pronë banesore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, me përjashtim të kërkesave me nr. 00464, 00814, 00964, 01340, 11706, 11794, 31924 dhe 51053, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat banesore, përfshirë tokën e bashkuar. Në kërkesat me nr. 00464, 00814, 00964, 01340, 11706, 11794, 31924 dhe 51053 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit.

8. Ky vendim përfshin 103 kërkesa për pronë banesore të cilat janë të shënuar në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 226 kërkesave për pronë banesore përfshihen në vendimet KPCC/D/R/165/2012 dhe KPCC/D/R/166/2012.

9. Të 67 kërkesat e shënuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një palë që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Të 36 kërkesat e shënuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht

UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'u ofruar personave që mund të kenë interes ligjor në pronë me mundësinë për t'i dhënë përgjigje kërkesës sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

11. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

12. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

13. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda

juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

15. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

I. Kërkesa kontestuese – vendime për hedhje poshtë.

1. Tjetërsimi vullnetar apo aftësia për të ushtruar të drejtat pronësore.

a. Shitje pas konfliktit

16. Në nëntëmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, kërkesat janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla, ka paraqitur mbrojtje në mbështetje të kërkesës. Në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë pretenduar fillimisht se ata ose familjet e tyre kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave me vonë informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre, sipas rastit, i kanë shitur pronat e kërkuara tek një palë e tretë pas konfliktit, bazuar në kontratën e vlefshme të shitjes.

17. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se në këto kërkesa paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore sipas rastit, nuk e kanë humbur posedimin për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes e cila tregon se këta paraqitës të kërkesës ose mbajtës të së drejtës pronësore, sipas rastit, kanë tani mundësinë për të ushtruar të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 22409

18. Kërkesa nr. 22409 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës e ka trashëguar pronën e kërkuar në bazë të vendimit të trashëgimisë datë 14 shkurt 2003 nga mbajtësi i ndjerë i së drejtës pronësore. Mbajtësi i së drejtës pronësore shënohet si pronar në fletën poseduese datë 22 mars 2002 e cila është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

19. Pala përgjegjëse pretendon të jetë pronar me të drejta të plota i pronës së kërkuar dhe pohon se e ka blerë pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse, në mbështetje të pretendimit të tij, ka paraqitur dy kontrata të blerjes midis paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse respektivisht datë 13 prill 2001 dhe 27 shkurt 2003. Pala

përgjegjëse ka paraqitur gjithashtu certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të lëshuar më datën 3 mars 2011 e cila e tregon palën përgjegjëse si mbajtësin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Komisioni konsideron se në kohën e kontratës së parë të blerjes datë 13 prill 2001, paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë pronar i pronës së kërkuar pasi ai e ka trashëguar pronën e kërkuar në vitin 2003. Rrjedhimisht, pala përgjegjëse nuk ka mundur të përfitojë pronësinë për pronën e kërkuar mbi bazën e kësaj kontrate. Megjithatë, kontrata e dytë e blerjes e vitit 2003 është nënshkruar në emër të paraqitësit të kërkesës nga një palë e tretë të cilit i ishte dhënë autorizim nga paraqitësi i kërkesës. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar autorizimin si të vërtetë. Rrjedhimisht, pala përgjegjëse e ka përfutur pronësinë për pronën e kërkuar mbi bazën e kontratës së dytë të blerjes në vitin 2003.

20. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se mbajtësit e së drejtës pronësore nuk a kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit të 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes, e cila tregon se paraqitësi i kërkesës ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

c. Kërkesat nr. 53790 dhe 54799

21. Kërkesat nr. 53790 dhe 54799 janë depozituar nga paraqitësit e kërkesave në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Të dyja kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ka paraqitur mbrojtje për kërkesën. Në të dyja kërkesat paraqitësit e kërkesave pretenduan fillimisht se ata ose familjet e tyre i kishin humbur pronat e kërkuara për shkak të konfliktit të 1998-1999. Megjithatë, me pas, paraqitësit e kërkesës e informuan Sekretarinë Ekzekutive se pronat e kërkuara ishin shkëmbyer nga ata ose familjet e tyre, sipas rastit, me një palë të tretë pas konfliktit.

22. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se në kërkesat nr. 54799 dhe 53790, mbajtësit e së drejtës pronësore nuk a kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit të 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes, e cila tregon se mbajtësi i së drejtës pronësore ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

2. Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit

a. Kërkesa nr. 00446

23. Kërkesa nr. 00446 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai ka banuar së bashku më palën përgjegjëse i cili është vëllai i paraqitësit të kërkesës, në pronën e kërkuar deri në kohën e konfliktit. Paraqitësi i kërkesës shpjegon se ai u largua nga prona e kërkuar gjatë konfliktit, ndërsa pala përgjegjëse qëndroi në pronën e kërkuar dhe shfrytëzoi mungesën e paraqitësit të kërkesës për të uzurpuar pronën e kërkuar, i cili refuzon ta lirojë atë.

24. Pala përgjegjëse pretendon se vëllai i tij po përpiqet të mashtrojë AKP-në pasi paraqitësi i kërkesës nuk e ka përfutur asnjëherë pronën e kërkuar. Pasi pala përgjegjëse ndërroi jetë, Sekretaria Ekzekutive bëri përpjekje të kontaktojë djalin e palës përgjegjëse, por nuk pati sukses pasi ai nuk u tregua bashkëpunues.

25. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se humbja e pretenduar e aftësisë për të ushtruar të drejtat pronësore për pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës nuk është për shkak të konfliktit të armatosur por për shkak të një kontesti familjar në lidhje me trashëgiminë e pronës së kërkuar. Rrjedhimisht ajo bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

b. Kërkesa nr. 01023

26. Kërkesa nr. 01023 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti disa dokumente përfshirë kontratën e blerjes të vitit 2006 dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës të vitit 2007, të dyja tregojnë se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2006. Të dy dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Pala përgjegjëse, i cili ka uzurpuar pronën e kërkuar, kërkon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar.

27. Komisioni konsideron se, pasi paraqitësi i kërkesës e ka përfituar pronësinë vetëm në vitin 2006 dhe për rrjedhojë pas konfliktit të 1998-99, nuk mund të ketë humbje të posedimit ose aftësisë për të ushtruar të drejtat pronësore për shkak të konfliktit. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

c. Kërkesa nr. 11655

28. Kërkesa nr. 11655 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësi të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti dokumente të panumërta përfshirë kontratën e blerjes të vitit 2006 e cila tregon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2006. Pala përgjegjëse e konteston kërkesën duke kërkuar të drejtë ligjore për pronën e kërkuar por dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij.

29. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka përfituar pronësinë për pronën e kërkuar vetëm në vitin 2006 dhe për rrjedhojë pas konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

d. Kërkesa nr. 11706

30. Kërkesa nr. 11706 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti disa dokumente përfshirë një kontratë shfrytëzimi për pronën e kërkuar të vitit 1973. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës shpjegon gjithashtu se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në vitin 1982.

31. Pala përgjegjëse e konteston kërkesën e paraqitësit të kërkesës duke pretenduar se babai i tij është pronari ligjor i pronës së kërkuar bazuar në një kontratë blerje të vitit 2006 të lidhur mes babait të palës përgjegjëse dhe një pale të tretë. Dokumenti është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë.

32. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni vëren se në bazë të deklaratës të vetë paraqitësit të kërkesës humbja e posedimit ka ndodhur në vitin 1982 dhe për rrjedhojë

nuk ndërlidhet me konfliktin e 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

e. Kërkesa nr. 11545

33. Kërkesa nr. 11545 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës përmes përfaqësuesit të autorizuar në cilësinë e mbajtës të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon confirmimin e të drejtave pronësore dhe riposelimin e pronës së kërkuar dhe në mbështetje të kërkesës ka paraqitur lloje te ndryshme dokumentesh. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ka jetuar në pronën e kërkuar deri në vitin 1945 kur u detyrua të largohet nga Kosova. Paraqitësi i kërkesës nuk ka përcaktuar se kush e ka detyruar të largohet nga prona e kërkuar po ashtu nuk ka paraqitur mbrojtje te vlefshme në mbështetje të pretendimit të tij.

34. Pala përgjegjëse e kontestoi të drejtën ligjore të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar dhe paraqiti *inter alia* një vendim trashëgimie të verifikuar pozitivisht të vitit 1982 i cili tregon se pala përgjegjëse ka trashëguar ¼ pjesë ideale të pronës së kërkuar.

35. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se humbja e posedimit të paraqitësit të kërkesës ka ndodhur tashmë në vitin 1945 dhe për rrjedhojë nuk ndërlidhet me konfliktin e 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

f. Kërkesat nr. 92419, 92438, 92439, 92441, 92442, 92443, 92444, 92445, 92446, 92447, 92448, 92449, 92450, 92451 dhe 92453

36. Kërkesat nr. 92419, 92438, 92439, 92441, 92442, 92443, 92444, 92445, 92446, 92447, 92448, 92449, 92450, 92451 dhe 92453 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ajo e kishte humbur aftësinë për të ushtruar të drejtat pronësore për pronën e kërkuar gjatë viteve 1980.

37. Pala përgjegjëse e kontestoi pretendimin e paraqitësit të kërkesës duke kërkuar të drejtë ligjore për pronën e kërkuar.

38. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se humbja e posedimit të paraqitësit të kërkesës ka ndodhur tashmë në vitet 1980 dhe për rrjedhojë nuk ndërlidhet me konfliktin e 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

g. Kërkesa nr. 11680

39. Kërkesa nr. 11680 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2007, por nuk ka pasur mundësi të marrë posedimin e pronës pasi ka qenë e uzurpuar nga pala përgjegjëse. Pala përgjegjëse i kontestoi të drejtat ligjore të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

40. Gjatë një bisede telefonike me Sekretarinë Ekzekutive në vitin në vitin 2011, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se kontesti me palën përgjegjëse ishte zgjidhur dhe ai

është në posedim të pronës së kërkuar që nga ajo kohë. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi tani paraqitësi i kërkesës ka mundësi të ushtrojë të drejtat pronësore.

h. Kërkesa nr. 11794

41. Kërkesa nr. 11794 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaron se atij i është dhënë e drejta e shfrytëzimit në vitin 1985 për pronën e kërkuar (një banesë) nga autoriteti publik 'Brigada e Zjarrfikëseve' në Prizren me anë të dy vendimeve të ndarjes të vitit 1985 dhe 1999. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta duke përfshirë vendimet e ndarjes. Megjithatë paraqitësi i kërkesës pranon se nuk e ka marrë posedimin e pronës së kërkuar deri në vitin 2000. Paraqitësi i kërkesës shpjegon se ai tashmë kishte depozituar një kërkesë për riposedimin e së njëjtës pronë të kërkuar para DÇPB-së. Megjithatë në vendimet e tij HPCC/D/117/2004A&C të vitit 2004, KKPB-ja hodhi poshtë kërkesën dhe në vitin 2005 paraqitësi i kërkesës është dëbuar nga DÇPB-ja.

42. Pala përgjegjëse e konteston kërkesën e paraqitësit të kërkesës duke pohuar së një palë e tretë, Goran Mijovic, e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2008, megjithatë ai nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij.

43. Komisioni vëren se pasi që paraqitësi i kërkesës ka përfutur posedimin për pronën e kërkuar vetëm në vitin 2000 dhe për rrjedhojë pas konfliktit të 1998-99, humbja e tij nuk ndërlidhet me konfliktin. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë se bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

i. Kërkesat nr. 38629 dhe 48664

44. Kërkesa nr. 38629 është paraqitur fillimisht nga paraqitësi i kërkesës ("Paraqitësi i parë i kërkesës") në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës ajo ka paraqitur vendimin e trashëgimisë të vitit 1993 i cili tregon se ajo është bërë bashkëpronare të pjesës ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar pas vdekjes së bashkëshortit të saj. Dokumenti është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i parë i kërkesës u largua nga prona e kërkuar në vitin 1999, por vazhdoi ta vizitojë çdo vit pronën e kërkuar. Paraqitësi i parë i kërkesës ndërroi jetë pas depozitimit të kërkesës.

45. Kërkesa nr. 48664 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ("Paraqitësi i dytë i kërkesës") në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i dytë i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore të bashkëpronësisë për pjesën ideale prej 2/3 dhe riposedimin e pronës së kërkuar e cila është e njëjta pronë si ajo që kërkohet nga paraqitësi i parë i kërkesës. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i dytë i kërkesës, paraqiti *inter alia* të njëjtin vendim të trashëgimisë të vitit 1993 si atë të paraqitësit të parë të kërkesës. Dokumenti e tregon atë si bashkëpronar tjetër me pjesën ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar. Me tej, paraqitësi i dytë i kërkesës paraqiti kontratën për përkujdesjen jetësore të lidhur mes paraqitësit të parë të kërkesës si përfutues dhe paraqitësit të dytë të kërkesës si ofrues në bazë të secilës paraqitësi i dytë i kërkesës pretendon të ketë fituar të drejtën e bashkëpronësisë të paraqitësit të parë të kërkesës për 1/3 e pronës së kërkuar pasi ajo ndërroi jetë. Paraqitësi i parë i kërkesës ishte nëna e paraqitësit të dytë të kërkesës. Paraqitësi i dytë i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ai është larguar nga prona e kërkuar në vitin 1982.

46. Pala përgjegjëse, i cili është një djalë tjetër i paraqitësit të parë të kërkesës, kërkon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar duke pretenduar se edhe ai është bashkëpronar me të drejta te plota i pronës së kërkuar dhe po ashtu e kundërshton *inter alia* vlefshmërinë e kontratës për përkujdesjen jetësore mes paraqitësit të parë të kërkesës dhe paraqitësit të dytë të kërkesës.

47. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i parë i kërkesës, bazuar në konfirmimin e saj se ajo ka vazhduar ta vizitojë pronën, nuk a ka humbur posedimin e pronës për shkak të konfliktit të 1998-99. Sa i takon kërkesës së paraqitësit të dytë të kërkesës, Komisioni vëren se paraqitësi i dytë deklaron se ai është larguar nga prona e kërkuar në vitin 1992. Rrjedhimisht pretendimi i paraqitësit të dytë të kërkesës për humbjen e aftësisë për të ushtruar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar nuk është për shkak të konfliktit të armatosur por për shkak të një kontesti familjar në lidhje me vlefshmërinë e kontratës për përkujdesjen jetësore. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për konteste të tilla familjare. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

j. Kërkesa nr. 00964

48. Kërkesa nr. 00964 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se mbajtësi i së drejtës pronësore ka të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar bazuar në një vendim të ndarjes dhe se mbajtësi i së drejtës pronësore ka humbur posedimin e pronës së kërkuar gjatë konfliktit. E vetmja dëshmi e rëndësishme e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës është vendimi që i miraton mbajtësit të së drejtës pronësore të drejtën e përkohshme të banimit në pronën e kërkuar.

49. Komisioni konsideron se vendimi i ndarjes për të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit të pronës së kërkuar nuk provon vërtetimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar që ka mundësinë e rikthimit sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me ligjin nr. 03/L-07. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

3. Res judicata

50. Kërkesat nr. 00882, 01248, 01340, 01376, 50381, 50890 dhe 52349, të referuara në pjesën B të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi respektiv i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Kërkesat në pjesën B janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë, ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Në mbështetje të kërkesave janë paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh të cilat janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose janë siguruar nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio*, përfshirë fletët poseduese, kontratat e ndarjes së pronës, vendimet e trashëgimisë, vendimet e gjykatës për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Megjithatë, dëshmitë para Komisionit të cilat janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose pala përgjegjëse dhe janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive ose janë siguruar nga Sekretaria *ex officio*,

tregojnë se të gjitha këto kërkesa janë shqyrtuar dhe vendosur me herët me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë.

51. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni hedh poshtë kërkesën e cila është shqyrtuar dhe vendosur me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë. Rrjedhimisht, kërkesat nr. 00882, 01248, 01340, 01376, 50381, 50890 dhe 52349 duhet të hidhen poshtë.

4. Padi në pritje për t'u gjykuar para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

52. Kërkesa nr. 49180 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh. Megjithatë, dëshmitë e paraqitura nga paraqitësi i kërkesës dhe të verifikuara nga Sekretaria Ekzekutive tregojnë se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka depozituar padi para datës 16 tetor 2006 në gjykatën kompetente ku kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore për pronën e kërkuar.

53. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën para datës 16 tetor 2006, datë kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

II. Kërkesa jokontestuese- vendime për hedhjen poshtë.

1. Tjetërsimi vullnetar ose aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore.

a. Shitja pas konfliktit

54. Në 21 kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur kërkesat janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare. Kërkesat e identifikuar në pjesën A janë jokontestuese. Në të gjitha këto kërkesat, paraqitësit e kërkesave kanë pretenduar fillimisht se ata ose familjet e tyre kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave më vonë informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre, sipas rastit, i kanë shitur pronat e kërkuara tek një palë e tretë pas konfliktit bazuar në kontratë të vlefshme të shitjes.

55. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se në këto kërkesa, paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore sipas rastit, nuk e kanë humbur posedimin për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes e cila tregon se këta paraqitës të kërkesës ose mbajtës të së drejtës pronësore, sipas rastit, kanë tani mundësinë për të ushtruar të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 40324

56. Kërkesa nr. 40324 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj të ndjerë. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 1972 e regjistruar në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën aktuale poseduese të regjistruar në emër të një pale të tretë si pronar i ligjshëm i pronës së kërkuar. Sipas zyrtarit kadastral kompetent të zyrës përkatëse kadastrale, prona është shitur nga familja e paraqitësit të kërkesës tek një palë e tretë në vitin 2003. Paraqitësi të kërkesës iu kërkua të paraqitë dëshmi të tjera në mbështetje të kërkesës por dështoi ta bëjë këtë.

57. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se mbajtësit e së drejtës pronësore nuk a kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit të 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes pas konfliktit. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

2. Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit.

a. Kërkesa nr. 28291

58. Kërkesa nr. 28291 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Megjithatë, me pas, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ai ishte larguar nga Kosova 35 vite më parë për arsye ekonomike. Ai pranon se e viziton pronën e kërkuar herë pas herë dhe nuk është ndaluar nga ushtrimi i së drejtave pronësore.

59. Komisioni arrin në përfundimin se, në mungesë të dëshmisë për humbjen e posedimit të pronës së kërkuar, e ndërlidhur kjo me konfliktin, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

b. Kërkesat nr. 33909 dhe 33911

60. Kërkesat nr. 33909 dhe 33911 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj. Megjithatë, me pas paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se ai ishte larguar nga Kosova në vitet 1980. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi gjithashtu se uzurpuesi i tanishëm i pronës së kërkuar po i shfrytëzon pronat e kërkuara me lejen e saj. Komisioni arrin në përfundimin se, në mungesë të dëshmisë për humbjen e posedimit të pronës së kërkuar, e ndërlidhur kjo me konfliktin, kërkesat duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit.

3. Res judicata

61. Kërkesat nr. 00154, 28914 dhe 53138, të referuara në pjesën A të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi respektiv i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore duke kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore të mbajtësit të

pretenduar të së drejtës pronësore dhe riposedimin. Kërkesat e identifikuar në pjesën A janë jokontestuese. Në mbështetje të kërkesave pronësore janë paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh të cilat janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose janë siguruar nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio*, përfshirë fletët poseduese, kontratat e ndarjes së pronës, vendimet e trashëgimisë, vendimet e gjykatës për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Megjithatë, dëshmitë para Komisionit të cilat janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose pala përgjegjëse dhe janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive ose janë siguruar nga Sekretaria *ex officio*, tregojnë se të gjitha këto kërkesa janë shqyrtuar dhe vendosur me herët me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë.

62. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni hedh poshtë kërkesën e cila është shqyrtuar dhe vendosur me vendim administrativ ose gjyqësor të formës së prerë. Rrjedhimisht, kërkesat nr. 00154, 28914 dhe 53138 duhet të hidhen poshtë.

4. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.

63. Kërkesat nr. 17855, 31010, 33825 dhe 36298, të referuara në pjesën A të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi respektiv i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore duke kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe riposedimin. Kërkesat janë jokontestuese. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave nuk kanë ofruar dëshmi se ata gëzojnë të drejtat pronësore për pronat e kërkuara e po ashtu Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar *ex officio* dëshmi të tillë. Paraqitësit e kërkesave nuk janë anëtarë të bashkësisë familjare ashtu si përcaktohet në nenin 1 dhe nenin 5 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, në mënyrë që të depozitojnë kërkesë në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Po ashtu paraqitësit e kërkesës nuk mbajnë autorizim të bërë sipas rregullit ku ata të autorizohen për të vepruar në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

64. Rrjedhimisht, pasi paraqitësve të kërkesës u mungon baza ligjore në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare dhe pasi ata nuk janë pajisur me autorizim të vlefshëm, kërkesat duhet të hidhen poshtë.

65. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për arsye të cekura më sipër.

C. Kërkesa të refuzuara.

66. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

67. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

I. Kërkesa kontestuese – vendime për refuzime

a. Kërkesat nr. 00464, 00814 dhe 23361

68. Kërkesat nr. 00464, 00814 dhe 23361 kërkesat janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare. Kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla, ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Megjithatë, Komisioni konsideron se në secilën nga këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të paraqitin dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar të drejtën e pretenduar të shfrytëzimit pasi secili prej tyre paraqiti vetëm vendimin e ndarjes por jo dëshmi të tjera si kontrata e shfrytëzimit. Në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (42/86) i ndryshuar më Ligjin për Banesat (50/92), vetëm vendimi i ndarjes nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar të drejtën e shfrytëzimit në formën e së drejtës së banimit; e drejta e tillë lind vetëm kur merret posedimi ose lidhet kontrata e shfrytëzimit.

69. Pasi paraqitësit e kërkesave në kërkesat nr. 00464, 00814 dhe 23361 kanë dështuar të ofrojnë dëshmi të mjaftueshme se ata plotësojnë kërkesat përkatëse statusore për të drejtën e shfrytëzimit, kërkesat duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 06718

70. Kërkesa nr. 06718 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim gjyqësor të verifikuar pozitivisht që konfirmon pronësinë e tij për pronën e kërkuar.

71. Pala përgjegjëse pretendon se paraqitësi i kërkesës e ka humbur të drejtën pronësore për pronën e kërkuar të cilën e ka marrë pala përgjegjëse në bazë të kontratës së blerjes të lidhur mes paraqitësit të kërkesës si shitës dhe palës përgjegjëse si blerës. Sipas palës përgjegjëse, kontrata e blerjes përcakton kthimin e pronësisë tek pala përgjegjëse në rast se paraqitësi i kërkesës dështon të përmbushë detyrimet e pagesës në afatin e caktuar. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dështuar të përmbushë këtë detyrim, pala përgjegjëse pretendon se ka përfutur pronësinë për pronën e kërkuar. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës e mohon ekzistencën e kësaj kontrate.

72. Gjatë seancës së 28-të të mbajtur në prill 2012 Komisioni urdhëroi mbajtjen e seancës dëgjimore në kërkesën nr. 06718 nga një prej anëtarëve të tij në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, në bazë të vendimit të Komisionit, paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse, dhe një dëshmitar i caktuar nga pala përgjegjëse, u ftuan për të marrë pjesë në seancë dëgjimore më 17 prill 2012. Megjithatë vetëm pala përgjegjëse erdhi në seancë. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se nuk mund të merrte pjesë pasi nuk mund të udhëtonte për shkak të gjendjes shëndetësore dhe situatës së vështirë ekonomike. Dëshmitari i ftuar deklaroi se detyra e tij si gjykatës nuk e lejon të shërbejë si dëshmitar. Gjatë seancës, pala përgjegjëse konfirmoi deklaratat e tij të mëparshme duke përfshirë atë se kishte marrë posedimin e pronës së kërkuar në vitin 1998, dhe paraqiti një kopje të kontratës së blerjes mes paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse në bazë të secilës paraqitësi i kërkesës në të vërtetë kishte rënë dakord që prona e kërkuar të kthehej në emër të palës përgjegjëse nëse paraqitësi i kërkesës dështonte të përmbushte detyrimet e pagesës. Më tej, pala përgjegjëse paraqiti një kopje të vendimit gjyqësor që konfirmonte pronësinë e paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar të lëshuar para lidhjes së kontratës të blerjes. Sekretaria i ka verifikuar të dy dokumentet si të vërteta.

73. Komisioni, bazuar në dëshmitë para tij, konstaton se paraqitësi i kërkesës ka humbur te drejtën pronësore për pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse, në bazë të kushteve të kontratës së blerjes. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet.

c. Kërkesa nr. 00747

74. Kërkesa nr. 00747 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga një palë e tretë në vitin 1997. Megjithatë, pala e tretë e mohon marrëdhënien kontraktore me paraqitësin e kërkesës duke deklaruar në fakt ai ia ka shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse dhe jo paraqitësit të kërkesës.

75. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij, përveç dy vendimeve gjyqësore të vitit 2006 të lëshuar nga gjykata paralele e Prishtinës dhe të vitit 2009 nga Gjykata e Rregullt e Prishtinës. Komisioni nuk konsideron se vendimi i gjykatës paralele përbën dëshmi të vlefshme. Sa i takon vendimit të dytë gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës në vitin 2009, Komisioni vëren se procedimi në këtë rast ka filluar vetëm pas datës 16 tetor 2006 dhe rrjedhimisht gjykatës i ka munguar juridiksioni në bazë të nenit 19 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar më Ligjin nr. 03/L-079.

76. Komisioni, bazuar në dëshmitë para tij, arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

d. Kërkesat nr. 00806 dhe 53122

77. Kërkesat nr. 00806 dhe 53122 janë depozituar nga paraqitësi respektiv i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar si pas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Të dy kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë, ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës.

Paraqitësit e kërkesës, kërkojnë në secilën kërkesë konfirmimin e së drejtës pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore për pronat e kërkuar dhe riposedimin. Megjithatë, në secilën kërkesë, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqitë dëshmi në mbështetje të të drejtave pronësore të pretenduara për pronat e kërkuara.

78. Në këto rrethana, kur paraqitësit e kërkesës kanë dështuar të dëshmojnë se kanë pasur të drejta pronësore para ose gjatë konfliktit të 1998-1999, kërkesa duhet të hidhet poshtë .

e. Kërkesat nr. 34084 dhe 48287

79. Kërkesat nr. 34084 dhe 48287 janë depozituar nga paraqitësit e kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Të dy kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor ne pronën e tillë, ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Megjithatë, Komisioni vëren se në të dyja kërkesat mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore e ka humbur pronësinë e pronës së kërkuar bazuar në vendimin e trashëgimisë të formës së prerë. Në kërkesën nr. 34084 vendimi i trashëgimisë është i vitit 2009 dhe në kërkesën nr. 48287 vendimi i trashëgimisë është i vitit 2002. Ajo që është më e rëndësishmja, në të dy kërkesat, trashëgimtari respektiv e ka shitur pronën e kërkuar tek një palë e tretë, në kërkesën nr. 34084 në vitin 2009 dhe në kërkesën nr. 48287 në vitin 2002.

80. Në këto rrethana, kur paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të dëshmojnë të drejtën pronësore për pronat e kërkuar, kërkesat duhet të refuzohen.

f. Kërkesat nr. 54358, 54366 dhe 91197

81. Kërkesat nr. 54358, 54366 dhe 91197 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar si pas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë, ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Në secilën nga kërkesat, paraqitësit e kërkesave pretenduan fillimisht se ata ose familjet e tyre i kanë humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit 1998-1999. Megjithatë, më pas, paraqitësit e kërkesave e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre , sipas rastit, i kishin tjetërsuar vullnetarisht pronat e kërkuara para konfliktit të 1998-1999.

82. Në këto rrethana kur paraqitësit e kërkesave kanë pranuar se ata nuk kanë pasur të drejta pronësore për pronat e kërkuara menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99, kërkesat duhet të refuzohen.

g. Kërkesa nr. 49028

83. Kërkesa nr. 49028 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ka shprehur interes ligjor për pronën e kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti një lejë ndërtimi që i miraton paraqitësit të kërkesës të drejtën të ndërtojë një banesë mbi pronën e kërkuar. Megjithatë, Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës nuk kishte përfunduar punimet e

ndërtimit para largimit nga Kosova. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 22 Të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Themelore, paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur të drejta pronësore për pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99 dhe për rrjedhojë nuk ka pasur mundësi ti humbasë ato për shkak të konfliktit.

84. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë se ai ka pasur të drejta pronësore për pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99, kërkesa duhet të refuzohet.

II. Kërkesa jokontestuese - vendime për refuzime

a. Kërkesat nr. 22314 dhe 51083

85. Kërkesat nr. 22314 dhe 51083 janë depozituar nga paraqitësi respektiv i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar si pas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Këto kërkesa janë jokontestuese.

86. Paraqitësit e kërkesës, në secilën kërkesë, kërkojnë konfirmimin e së drejtës pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Megjithatë, në kërkesën nr. 51083 paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqitë dëshmi në mbështetje të së drejtës pronësore të pretenduar për pronën e kërkuar. Në kërkesën nr. 22314 paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vetëm një kopje të paverifikuar të një kontratë të blerjes të panënshkruar e cila është e palexueshme në disa pjesë.

87. Në këto rrethana, kur paraqitësit e kërkesës kanë dështuar të dëshmojnë se kanë pasur të drejta pronësore para ose gjatë konfliktit të 1998-1999, kërkesat duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 37347

88. Kërkesa nr. 37347 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Kërkesa është jokontestuese. Fillimisht paraqitësi i kërkesës pretendoi se familja e tij e kishte humbur pronën e kërkuar si rezultat i konfliktit të 1998-1999. Megjithatë, me pas, paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se e kishte tjetërsuar vullnetarisht pronën e kërkuar para konfliktit të 1998-1999.

89. Në këto rrethana kur paraqitësit e kërkesave kanë pranuar se ata nuk kanë pasur të drejta pronësore për pronat e kërkuara menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99, kërkesat duhet të refuzohen.

c. Kërkesa nr. 31924

90. Kërkesa nr. 31924 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortes së tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar (banesë) dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vetëm vendimin e ndarjes por jo kontratën e shfrytëzimit. Megjithatë sipas Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (42/86) i ndryshuar

me Ligjin për banesat (50/92) vendimi i ndarjes, marrja e posedimit dhe lidhja e kontratës duhet të ekzistojnë të gjitha para se të lindë e drejta e shfrytëzimit në formën e së drejtës së banimit.

91. Për rrjedhojë, pasi paraqitësi i kërkesës ka dështuar të ofrojë dëshmi të mjaftueshme se ai ka përmbushur kërkesat statusore për të drejtën e shfrytëzimit, kërkesa duhet të refuzohet.

D. Kërkesa për kompensim

92. Në kërkesat nr. 00882, 01187, 01376, 11545, 22314, 22644, 25024, 32318, 35345, 35955, 36298, 40052, 40324, 48287, 48664 dhe 53122 paraqitësi i kërkesës përveç pronësisë kërkon gjithashtu kompensimin për demin fizik të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa për kompensim hidhen poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse

93. Nisur sa më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e shënuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur duhet të hidhen poshtë dhe kërkesat e shënuar në pjesët B dhe kërkesat e shënuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur duhet të refuzohen dhe udhëzon të nxirret një urdhër në lidhje me secilin kërkesë ashtu si është përcaktuar më sipër.

94. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

95. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA07173	KPA11758	KPA31010	KPA33911	KPA50459	KPA50465	KPA06854
KPA29811	KPA00154	KPA33909	KPA44274	KPA51855	KPA06683	KPA13109
KPA17855	KPA28291	KPA33825	KPA34178	KPA35955	KPA40052	KPA56411
KPA91294	KPA91326	KPA01388	KPA06853	KPA22644	KPA35345	KPA40324
KPA28914	KPA36298	KPA53138	KPA25831			

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA01340	KPA11706	KPA37133	KPA50381	KPA00882	KPA01376	KPA28655
KPA32318	KPA44737	KPA50890	KPA00132	KPA00446	KPA00964	KPA06880
KPA11655	KPA50727	KPA52349	KPA92419	KPA92438	KPA92439	KPA92441
KPA92442	KPA92443	KPA92444	KPA92445	KPA92446	KPA92447	KPA92448
KPA92449	KPA92450	KPA92451	KPA92453	KPA25394	KPA33057	KPA53262
KPA17099	KPA17139	KPA38629	KPA48664	KPA51053	KPA01187	KPA11680
KPA21011	KPA53790	KPA01023	KPA01248	KPA11545	KPA25024	KPA49180
KPA11794	KPA54799	KPA29101	KPA53156	KPA22409		

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA22314	KPA31924	KPA51083	KPA37347			
----------	----------	----------	----------	--	--	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part D/Pjesa D/Deo D

KPA23361	KPA00464	KPA34084	KPA49028	KPA00747	KPA00814	KPA48287
KPA53122	KPA00806	KPA54358	KPA54366	KPA91197	KPA06718	